



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

KRYETARI

Nr. 6347 Prot

Shkodër, më 19.03.2026

Lënda: Dërgohet për shqyrtim projekt-vendim dhe relacioni “Për një ndryshim në VKB nr.84, datë 18.12.2025 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2026 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2026-2028 të Bashkisë Shkodër”, i ndryshuar.

KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR

Të nderuar këshilltarë,

Bashkëngjitur ju dërgojmë për shqyrtim projekt-vendimin dhe relacionin: “Për një ndryshim në VKB nr.84, datë 18.12.2025 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2026 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2026-2028 të Bashkisë Shkodër”, i ndryshuar;

Duke ju uruar punë të mbarë.

Me respekt,





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

KRYETARI

Nr. 6347/Prot

Shkodër, më 19.03.2026

PROJEKT-VENDIM

Nr. _____, datë _____.2026

Për një ndryshim në VKB nr. 84, datë 18.12.2025 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2026 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2026-2028 të Bashkisë Shkodër”, i ndryshuar.

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e tij të datës _____.2026, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të nenit 54 shkronja “dh” të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar; ligjit nr.68/2017 “Për financat vendore”, i ndryshuar; ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; ligjit nr.10296, datë 8.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”; ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ligjit 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; Udhëzimit nr. 9, datë 20.3.2018 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, të ndryshuar; ligjit nr. 69/2012, “Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr.10352, datë 18.11.2010 “Për Artin dhe Kulturën”, i ndryshuar; të Vendimit nr.75, datë 6.2.2026, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës, të organikës dhe të numrit të nëpunësve të shërbimit të gjendjes civile në Bashki dhe në zyrat e arkivit të gjendjes civile pranë Prefektit të Qarkut”, të VKB nr.84, datë 18.12.2025 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2026 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2026-2028 të Bashkisë Shkodër”, i ndryshuar. si dhe relacionit të përgatitur nga administrata e Bashkisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë ndryshimin në VKB nr.84, datë 18.12.2025 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2026 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2026-2028 të Bashkisë Shkodër”, i ndryshuar, pika 1 germa g), sa i takon numrit total të punonjësve të Bashkisë Shkodër, sipas tabelës së SMBV, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Fondi i pagave për punonjësit shtesë të Bashkisë Shkodër përballohet nga fondet e trashëguara nga viti 2025 pjesë e buxhetit të bashkisë të vitit 2026.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.



ZV/KRYETAR

Drejtoria e Përgjithshme Juridike, Burimeve
Njerëzore dhe Shërbimeve Mbeshtetëse

B. Degge

Drejtoria Juridike

B. Degge

Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe
Shërbimeve mbështetëse

Arbete Perylli

Drejtoria e Administrimit të Sistemeve,
Menaxhimit të ZIN, Projekteve TIK dhe
Menaxhimit të Sistemeve të Informacionit

Elvin Risi

Drejtoria e Arsimit

Donatela Kallaj

Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore

Artur Bekari

Drejtoria e Përgjithshme e
Menaxhimit Financiar

Elvin Drahimi

Drejtoria e Analizës dhe
Programimit Buxhetor

Seila Haxhi

Drejtoria e Financës

Blerta Mydety

Ishte

Raporti : BV5 - Numri i Punonjesve te NJQV

NJQV : 141- Bashkia Shkoder

Buxheti : 2026

Institucioni	Kodi i institucionit	Numri i punonjesve të miratuar	Numri i punonjësve me kontratë
Bashkia Shkodër	2141001	645	20
Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpetimit	2141042	55	
Ndërmarrja e Shërbimeve dhe Punëve Publike	2141044	146	10
Drejtoria e Përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve Publike	2141045	248	
NUMRI I PUNONJËSVE		1,094	30
TOTALI (Efektet financiare me fondet e veta)	1,124		
Gjendja Civile - Efektet financiare me transfertë të kushtëzuar)	2141001	20	
TOTALI- (Efektet financiare me transfertë të kushtëzuar)		20	

BV5 - Numri i Punonjesve te NJQV

Dokumenti perfundimtar i PBA 2026-2028 dhe Buxheti 2026 - Miratuar nga Keshilli Bashkiak i NJQV (Faza III).

Bëhet

Raporti : BV5 - Numri i Punonjesve te NJQV

NJQV : 141- Bashkia Shkoder

Buxheti : 2026

Institucioni	Kodi i institucionit	Numri i punonjesve të miratuar	Numri i punonjesve me kontratë
Bashkia Shkodër	2141001	659	28
Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpetimit	2141042	55	
Ndërmarrja e Shërbimeve dhe Punëve Publike	2141044	146	10
Drejtoria e Përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve Publike	2141045	248	
NUMRI I PUNONJËSVE		1,108	38
TOTALI (Efektet financiare me fondet e veta)	1,146		
Gjendja Civile - Efektet financiare me transfertë të kushtëzuar)	2141001	7	
TOTALI- (Efektet financiare me transfertë të kushtëzuar)		7	

BV5 - Numri i Punonjesve te NJQV

Dokumenti perfundimtar i PBA 2026-2028 dhe Buxheti 2026 - Miratuar nga Keshilli Bashkiak i NJQV (Faza III).





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

KRYETARI

RELACION

Për një ndryshim në VKB nr. 84, datë 18.12.2025 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2026 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2026-2028 të Bashkisë Shkodër", i ndryshuar;

Të nderuar këshilltarë,

Në mbështetje të nenit 54 shkronja "dh", ligjit nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar; ligjit nr.68/2017 "Për financat vendore", i ndryshuar; ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; ligjit nr.10296, datë 8.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"; ligjit nr.152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, ligjit 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; Udhëzimit nr.9, datë 20.3.2018 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", të ndryshuar; ligjit nr. 69/2012, "Për Sistemin Arsimit Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ligjit nr.10352, datë 18.11.2010 "Për Artin dhe Kulturën", i ndryshuar; VKB nr.84, datë 18.12.2025 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2026 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2026-2028 të Bashkisë Shkodër", i ndryshuar, Bashkia Shkodër paraqet për shqyrtim relacion për:

1. Miratimin e rritjes së numrit të punonjësve në Drejtorinë e Administrimit të Sistemeve, Menaxhimit të ZIN, Projekteve TIK dhe Menaxhimit të Sistemeve të Informacionit, nga 12 që është aktualisht në 13 punonjës.
2. Miratimin e rritjes së numrit të punonjësve në Drejtorinë së Arsimit, nga 235, që është aktualisht, në 244 punonjës.
3. Miratimin e rritjes së numrit të punonjësve në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore, nga 30 që është aktualisht në 34 punonjës.
4. Shtesë numri të punonjësve të shërbimit me kontratë tek administrata me 8 punonjës.

Pra në total një rritje prej 22 punonjësish.

Kërkesa për rritjen e numrit të punonjësve tek Drejtoria e Administrimit të Sistemeve, Menaxhimit të ZiIN, Projekteve TIK dhe Menaxhimit të Sistemeve të Informacionit

Në kuadër të ofrimit të shërbimeve të qeverisjes elektronike (e-albania) sa më afër qytetarëve për të shmangur kostot financiare që qytetarët detyroheshin të paguanin pranë zyrave të

ndryshme të shërbimeve online, kemi hapur sportelin e-albania në strukturën e ZiIN pranë Bashkisë Shkodër.

Në këtë kuadër të njëjtin shërbim mendojmë të hapim edhe edhe pranë Njesisë Administrative Velipojë të Bashkisë Shkodër, nisur nga fluksi i lartë i qytetarëve që paraqiten për të kërkuar shërbimin në sportelin e ZiIN në Njësine Administrative Velipojë dhe nisur nga largësia që kanë banorët e kësaj njësie për të marrë këtë shërbim nga sporteli e-albania në bashkinë qendër.

Aktualisht në këtë njësi administrative nuk ka staf të dedikuar për sportelin e ZiIN, gjë që ka bërë që kërkesat dhe proceset administrative të mos menaxhohen në mënyrë të rregullt dhe efikase, sidomos gjatë periudhave me fluks të shtuar të qytetarëve.

Për këtë arsye, kërkojmë shtimin e stafit me 1 (një) nëpunës specialist, i cili të jetë i dedikuar për ofrimin e shërbimit e-albania në sportelin e ZiIN në Njësine Administrative Velipojë, me qëllim përmirësimin e cilësisë së shërbimit dhe menaxhimin më efikas të kërkesave të qytetarëve.

Kërkesa për rritjen e numrit të punonjësve tek Drejtoria e Arsimit vjen për arsye si vijon:

- I. Drejtoria e Arsimit pjesë e Bashkisë Shkodër në strukturën e saj ka 51 kopshte që ofrojnë shërbime për 1712 fëmijë të grupmoshës 0-6 vjeç, të ndara në: 21 kopshte në qytet dhe 30 në Njësi Administrative. Nga këto 7 kopshte dhe 7 çerdhe ofrojnë shërbim me drekë.

Në zbatim të Ligjit 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", Ligjit Nr. 68 datë 27.04.2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore", Ligjit Nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Ligjit nr. 69/2012 "Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", VKB Nr.84 datë 31.12.2025 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2026 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2026-2028 të Bashkisë Shkodër", i ndryshuar, në përmbushje të detyrimeve ligjore, paraqesim relacionin tonë për nevojën e miratimit nga ana juaj të shtesës së personelit në Drejtorinë e Arsimit.

Nga analiza e situatës aktuale rezulton se kemi një rritje të numrit të fëmijëve më aftësi ndryshe, me një shtrirje të madhe territoriale në të gjitha njësitë administrative (përveç atyre në qytet). Bazuar në nevojën e vlerësimeve periodike të fëmijëve më vonesë në zhvillim, funksion, që deri tani është mbuluar nga psikologët e Qendrës Harmonia, pjesë e strukturës së Drejtorisë së Shërbimit Social, stafi aktual është i pamjaftueshëm për realizimin cilësor të këtij shërbimi kaq të rëndësishëm për fëmijët.

Roli i psikologut është kyç në depistimin dhe trajtimin e problematikave zhvillimore të fëmijëve dhe konstatimi në një fazë sa më të hershme.

Mbështetur kjo dhe në Urdhër nr. 483, datë 19.09.2025 i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit “Për disa ndryshime në urdhrin nr. 313, datë 20.10.2020 “Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit psikosocial në institucionet e arsimit parauniversitar, i ndryshuar.

Gjithashtu në kuadër të funksionimit të institucioneve të edukimit të hershëm, prania e një infermieri në çerdhe konsiderohet një element i domosdoshëm për garantimin e shëndetit dhe sigurisë së fëmijëve.

Fëmijët e moshës së hershme kanë nevojë për monitorim të vazhdueshëm shëndetësor dhe për ndërhyrje të shpejtë në rastet e situatave emergjente apo problematikave të mundshme shëndetësore gjatë qëndrimit të tyre në institucion bazuar kjo e fundit dhe në Vendim nr.530, datë 20.7.2016 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e standardeve të projektimit të Çerdheve” prania e një infermieri është e domosdoshme.

Sa më sipër, Drejtoria e Arsimit paraqet për shqyrtim dhe miratim kërkesën për shtesë pozicioni.

A. 4 (katër) psikologë, të cilët do të angazhohen në ofrimin e shërbimeve psiko-sociale. Monitorimi i zhvillimit të fëmijëve, nëpërmjet vëzhgimeve dhe ndërhyrjeve sistematike në mjedisin ku rri fëmija dhe dokumentimi i tij në dosje.

B. 1 (një) infermier në çerdhe i cili do të kontribuojë në garantimin e shërbimit bazë shëndetësor.

Shtimi i këtyre pozicioneve do të ndikojë drejtpërdrejt në:

1. Përmirësimin e cilësisë së shërbimeve mbështetëse në kopshte;
2. Rritjen e mirëqenies psikologjike dhe sociale të fëmijëve;
3. Krijimin e një mjedisi arsimor më të sigurt dhe më gjithëpërfshirës;
4. Garantimin e një shërbimi bazë shëndetësor.

II. Krijimi i një Sektori të Përhershëm për Festivalin Mbarëkombëtar të Këngës për Fëmijë brenda Qendrës Kulture të Fëmijëve “Kujtim Alija”.

Qendra Kulture e Fëmijëve “Kujtim Alija” është një institucion i konsoliduar në fushën e edukimit jashtëshkollor, me strukturë të qartë organizative dhe përvojë të dëshmuar në menaxhimin e programeve gjatë gjithë vitit. Gjatë vitit mësimor 2024–2025, QKF ka ofruar 42 kurse jashtëshkollore të organizuara në tre sektorë (Arte, Sport, Tekniko–Shkencor), gjithashtu ka angazhuar 33 instruktorë të jashtëm dhe staf të brendshëm pedagogjik.

- Ka përfshirë 830 fëmijë në programe të rregullta edukative;
- Ka funksionuar mbi bazën e planeve mësimore, dokumentacionit të rregullt dhe koordinimit institucional.

Struktura aktuale e QKF është e orientuar kryesisht drejt zhvillimit të kurseve jashtëshkollore dhe menaxhimit të veprimtarisë pedagogjike të përditshme. Ajo ka dëshmuar stabilitet administrativ, disiplinë organizative dhe kapacitet për realizimin e aktiviteteve të përmasave të ndryshme. Për vitin shkollor 2025-2026, numri i fëmijëve që frekuentojnë qendrën është mbi 1000.

1. Rritja dhe rëndësia e Festivalit

Festivali Mbarëkombëtar i Këngës për Fëmijë, i zhvilluar pa ndërprerje që nga viti 1963, është një nga ngjarjet më të rëndësishme kulturore dhe edukative për fëmijët në Shqipëri. Për më shumë se gjashtë dekada, festivali ka promovuar talentet e reja dhe ka ndërtuar një identitet kombëtar të muzikës për fëmijë. Edicioni i 64-të, i planifikuar për 30–31 maj dhe 1 qershor 2026, synon të shënojë një hap cilësor duke e konsoliduar festivalin jo vetëm si një event artistik, por edhe si një platformë kombëtare me dimension edukativ dhe strukturë të gjithëvjeshme, në përputhje me nismat dhe programet e arsimit artistik në shkolla. Bashkia Shkodër po punon për lidhjen e një marrëveshjeje me Ministrinë e Arsimit që synon bashkëpunimin e Festivalit me programin “Art dhe Zeje” duke e pasuruar kurrikulen jashtëshkollore me materialet më të mira ndër vite, të prodhuara nga ky festival. Kjo marrëveshje do të bëhet për herë të parë në historinë e Festivalit dhe padyshim që do të ndikojë thellësisht në shtrirjen e festivalit si një platformë vjetore e gjithëpërfshirëse. Në vitin 2025 Bashkia ka nënshkruar me Rtsh një marrëveshje që përcakton këngën fituese të kategorisë junior në festival, si përfaqësuese të Shqipërisë në Junior Eurosong Contest, c’ka ia ka rritur vlerën festivalit por edhe ka shtuar ndjesëhm vizibilitetin e përfaqësimit shqiptar në këtë garë.

Rritja e festivalit dhe potenciali i tij për të lidhur edukimin formal me talentet artistike të fëmijëve nënvizon nevojën për krijimin e një sektori të përhershëm brenda QKF, i cili do të menaxhojë festivalin në mënyrë profesionale dhe gjithëvjetore, duke ruajtur traditën dhe trashëgiminë e tij, duke promovuar qytetin e Shkodrës në nivel kombëtar dhe mbarëshqiptar, dhe duke zhvilluar aktivitete të shtrira gjatë gjithë vitit.

2. Pse nevojitet një sektor i veçantë për festivalin

Aktualisht, organizimi i festivalit mbështetet në angazhime periodike dhe bashkëpunime të përkohshme. Kjo mënyrë funksionimi:

- E përqendron aktivitetin vetëm në periudhën e realizimit të edicionit;
- Nuk garanton një planifikim të plotë gjithëvjetor;
- Kufizon mundësinë e arkivimit, dokumentimit dhe promovimit të vazhdueshëm;
- Nuk e shfrytëzon plotësisht potencialin kulturor dhe turistik të festivalit.
- Mbivendos kompetencat dhe angazhimin e stafit të QKF për një veprimtari që tejkalon përshkrimin e tyre të punës.

Krijimi i një sektori të dedikuar nuk ndërhyt në kurset ekzistuese, por:

- Shton një njësi të specializuar me funksion të qartë;
- Ndan përgjegjësitë e festivalit nga veprimtaria rutinë pedagogjike;

- Garanton menaxhim profesional, afatgjatë dhe të strukturuar.

3. Objektivat strategjikë të sektorit të ri

1. Vazhdimësia dhe Platforma Gjithvjetore – Menaxhimi i festivalit gjatë gjithë vitit dhe zhvillimi i aktiviteteve artistike jashtë edicioneve.
2. Promovimi i Shkodrës si Qytet i Fëmijëve – Rritja e vizibilitetit të qytetit si qendër kulturore për fëmijë në nivel kombëtar dhe mbarëshqiptar.
3. Integrimi i Arsimit dhe Kulturës – Paketat edukative për shkollat 9-vjeçare dhe aktivitetet lidhur me festivalin.
4. Krijimi i një arkive digjitale të Festivalit si pasuri kombëtare kulturore
5. Koordinim Institucional dhe Partneritete – Bashkëpunim me shoqatën menaxhuese, RTSH, Ministrinë e Kulturës, Ministrinë e Arsimit dhe donatorë të tjerë.
6. Dimensioni Ekonomik dhe Turistik – Përdorimi i festivalit si motor për turizëm familjar dhe promovimin e qytetit.

4. Organizimi i Sektorit të Festivalit në QKF

4.1 Vendosja në organogramë

Sektori i Festivalit do të jetë një njësi funksionale brenda QKF, duke raportuar drejtpërdrejt te Drejtori i QKF, dhe do të mbulojë aspektet artistike, edukative dhe promocionale të festivalit gjatë gjithë vitit.

4.2 Struktura e Sektorit

- Koordinator Artistik / Përgjegjës Sektori (1 person) – ndihmon në drejtimin strategjik dhe artistik të festivalit; koordinimi me krijuesit; përfaqësimi institucional.
- Specialist i Programit Edukativ (1 person) – zhvillimi i paketave ekstrakurrikulare për shkollat 9-vjeçare; koordinimi me Drejtoritë e Arsimit.
- Specialist për Komunikim dhe Promovim (1 person) – ndërtimi i strategjisë promocionale të festivalit dhe Shkodrës; koordinimi me RTSH dhe mediat.
- Specialist Administrativ / Logjistik (opsional, 1 person) – mbështetje praktike për organizimin, dokumentacionin dhe koordinimin.

4.3 Funksione kryesore

- Hartimi i planit vjetor të festivalit;
- Ndërtimi i paketave edukative nga arkiva e festivalit;
- Organizimi i turneve verore dhe aktiviteteve gjatë vitit;
- Koordinimi me krijues dhe prindër;
- Dokumentimi, arkivimi dhe raportimi i aktiviteteve;
- Rritja e vizibilitetit të Shkodrës si qendër artistike dhe turistike;
- Bashkëpunimi i vazhdueshëm me Shoqatën bashkërealizuese të festivalit

5. Argumenti ekonomik dhe strategjik

- Turizëm dhe promovim: Aktivitetet gjithëvjete tërheqin vizitorë nga e gjithë Shqipëria dhe diaspora.
- Partneritete: Lehtëson bashkëpunimin institucional dhe menaxhimin financiar me shoqatën bashkëorganizatore.
- Vazhdimësi dhe efikasitet: Struktura e dedikuar rrit cilësinë dhe profesionalizmin.
- Përfitim edukativ: Integrimi në aktivitetet ekstra-kurrikulare dhe zhvillimi i paketave edukative përforcon ndikimin te brezat e rinj.

Ky sektor do të konsolidojë Shkodrën si qytet i artit dhe kulturës për fëmijë, duke shërbyer si model për qytetet e tjera në Shqipëri.

Në përfundim, duke vlerësuar rëndësinë e këtyre shërbimeve për funksionimin efektiv të institucioneve arsimore dhe për mirëqenien e fëmijëve, kërkohet miratimi i shtesës:

4 (katër) psikologë dhe 1 (një) infermier në strukturën e Drejtorisë së Arsimit të Bashkisë Shkodër

1 (një) Përgjegjës Sektori si dhe 3 (tre) Specialiste , në një sektor të brendshëm të Qendrës Kulturore të Fëmijëve “Kujtim Alija”.

Kërkesa për rritjen e numrit të punonjësve tek Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore kërkohet nga fakti se:

I. Në kuadër të përmirësimit të administrimit dhe mbledhjes së të ardhurave vendore, si dhe rritjes së efikasitetit në trajtimin e detyrimeve që lidhen me taksat dhe tarifat familjare, paraqitet nevoja për shtimin e një punonjësi në Sektorin e Shërbimit (Biznes + Familje). Aktualisht ky sektor përballet me një volum të lartë pune, për shkak të:

- a). numrit të madh të familjeve që administrohen në sistemin e taksave vendore;
- b). procesit të evidentimit dhe përditësimit të të dhënave të tatimpaguesve familjarë;
- c). ndjekjes së debitorëve dhe arkëtimit të detyrimeve të prapambetura;
- d). ofrimit të shërbimeve dhe informacionit për qytetarët lidhur me detyrimet e tyre fiskale.

Shtimi i një punonjësi në këtë sektor do të mundësojë:

1. Përmirësimin e administrimit të bazës së të dhënave të familjeve;
2. Rritjen e efikasitetit në procesin e identifikimit dhe ndjekjes së debitorëve;
3. Përshtetësimin e procedurave të shërbimit ndaj qytetarëve;
4. Rritjen e nivelit të arkëtimit të të ardhurave nga taksat dhe tarifat familjare.

Në këto kushte propozohet shtimi i një pozicioni pune në strukturën e Sektorit të Shërbimit (Biznes + Familje), me qëllim përmirësimin e performancës së sektorit dhe realizimin e objektivave të të ardhurave vendore.

Për sa më sipër, kërkohet miratimi për shtimin e 1 (një) punonjësi në Sektorin e Shërbimit (Biznes + Familje).

II. Bazuar në, VKB nr.43, datë 25.06.2025 “Për miratimin e kriterëve dhe përcaktimin e rrugëve dhe shesheve publike për administrimin e shërbimit të parkimit me pagesë, në Velipojë dhe Shirokë, të Bashkisë Shkodër”, dhe Urdhërit nr.98, datë 03.02.2026, të Kryetarit të Bashkisë Shkodër, Sektori i Transportit dhe Licencimit në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore, ka bërë një analizë për numrin e nevojshëm të punonjësve për administrimin e parkingjeve me pagesë. Analiza, përfshin parkingjet e miratuara në Shirokë (Shiroka 1 dhe Shiroka 2) dhe në Plazh të Njesisë Administrative Velipojë (Velipoja 1 dhe Velipoja 2).

Përshkrimi i situatës

Në kuadër të vendosjes në funksion dhe administrimit të parkingjeve me pagesë, është evidentuar nevoja për organizimin e burimeve njerëzore që do të garantojnë funksionimin normal, kontrollin e hyrje-daljeve, administrimin e pagesave dhe sigurinë e mjeteve.

Parkingjet paraqesin dy profile funksionimi:

- Parkingje me shërbim gjatë gjithë vitit (Shiroka 1 dhe Shiroka 2))
- Parkingje me shërbim sezonal (Velipoja 1 dhe Velipoja 2)

Analiza e nevojës për personel

Përcaktimi i numrit të punonjësve është bërë duke marrë në konsideratë:

- Kapacitetin e parkingjeve
- Orarin e funksionimit
- Fluksin e përdorimit
- Karakterin sezonal të aktivitetit
- Nevojën për mbulim me turne

Propozimi për numrin e punonjësve

a. Parkingjet “Shiroka 1”, “Velipoja 1”, “Velipoja 2

Numri i punonjësve: 11 (njëmbëdhjetë) 3 (tre) punonjës me kohë të plotë dhe 8 (tetë) punonjës sezonal tre muaj.

Parkingu “Shiroka 2”, për arsye të punimeve në aksin rrugorë Shirokë-Zogaj dhe infrastruktures jo të përshtatshme të tij, nuk mund të vihet në funksion si parking.

Argumentimi i strukturës së propozuar

- Siguron funksionim të pandërprerë të shërbimit.
- Përputhet me fluksin real të përdorimit të parkingjeve.

- Merr në konsideratë optimizimin e kostove përmes punësimit sezonal.
- Mundëson administrim të kontrolluar dhe transparent të të ardhurave.

Sa më sipër, i propozojmë Këshillit Bashkiak të miratojë projekt vendimin paraqitur;

Për një ndryshim në VKB nr.84, datë 18.12.2025 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2026 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2026 – 2028 të Bashkisë Shkodër”, të ndryshuar”;

Duke ju falenderuar!

KRYETAR

Benet BECI

